



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

PËR NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 100 DATË 22.12.2022
“ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2023 DHE PBA
2023-2025 ”,
(shtesa e buxhetit me fondet e papërdorura të trashëguara nga viti 2022)

Këshilli i Bashkisë pasi u njoh me materialin “Për ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 100 datë 22.12.2022 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2023 dhe PBA 2023-2025 ” (shtesa e buxhetit me fondet e papërdorura të trashëguara nga viti 2022), mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Miratimin e shtesës së buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 në shumën 210,603,836.15 lekë, me fondet e papërdorura të trashëguara nga viti 2022.
Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 100, datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2023 dhe PBA 2023-2025”, bëhen shtesat si më poshtë:

Në pikën 1 :

Gërma “A” shtohet : Të ardhurat gjithsej shtohen me 210,603,836.15 lekë në zërin :

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2022, specifikisht:

- a. Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme..... 5,663,551.51 lekë
- b. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale69,056,981.41 lekë
- c. Transferta Sektoriale për Projekte të Veçanta..... 25,121,160.00 lekë
- d. Të ardhurat e veta lokale..... 110,762,143.23 lekë

Gërma “B” shtohet: Shpenzimet gjithsej shtohen me 210,603,836.15 lekë në zërat :

- a. Shpenzime personeli 1,241,780.41 lekë
- b. Shp.operative & mirembajtje & te tjera 59,093,034.74 lekë
- c. Transferta për Buxhete Familje & Individë..... 5,711,205.00 lekë
- d. Shpenzime kapitale 144,557,816.00 lekë

Buxheti i Bashkisë Berat i vitit 2023 bëhet 1,493,087,870.15 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Në pikën 4 :

Detajimi i shtesës së buxhetit të vitit 2023 me të ardhurat e papërdorura të trashëguara nga viti 2022, bëhet sipas tabelave 1- 4 pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Miratimin e ndryshimeve në buxhetin e vitit 2023 (rishpërndarjeve të fondeve midis programeve si rezultat i fondeve të trashëguara nga viti 2022) sipas tabelës 5 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoritë e Bashkisë dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Tabela 1

Detajimi i Transfertës së Pakushtëzuar të Përgjithshme të trashëguar nga viti 2022

Kod Instituc.	Kap. Fin.	Prog rami	Llog.	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001	01	04520	231	1020182	Permiresim shtresa rrugore rruga Antipatrea, Kryqezimi i spitalit Rajonal - By Pass	4,720,005.00
2102001	01	09120	231	1020186	Bashkefinancim per projektin "Krijimi i kendit sportiv ne shkollen Velabisht"	184,000.00
2102001	01	08220	231	1020186	Bashkefinancim per projektin "Rivitalizimin e 100 fshtatrave – nderhyrjet ne Roshnik", bashkefinancim me AZHR	315,840.00
2102001	01	01110	602	9999999	Shpenzime operative per mallra e sherbime	192,166.51
2102001	01	01110	606	9999999	Transferta për Individë (detyrim për shperblimin e funksionareve qe kane lene detyren)	251,540.00
					Total	5,663,551.51

Tabela 2

Detajimi i Transfertës së Pakushtëzuar Sektoriale të trashëguar nga viti 2022

Kod Instituc.	Kap. Fin.	Prog rami	Llog.	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
		03280			Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	9,871,445.41
2102001	01	03280	600	9999999	Paga	1,000,000.00
2102001	01	03280	601	9999999	Sigurime shoqerore	241,780.41
2102001	01	03280	602	9999999	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,000,000.00
2102001	01	03280	231		Blerje pajisje	170,000.00
2102001	01	03280	606		Mbrojtja civile	3,459,665.00
		04240			Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	6,003,822.00
2102022	01	04240	6023	9999999	Karburant dhe vaj	785,000.00
2102022	01	04240	6023	9999999	Pjese kembimi, goma dhe bateri	311,389.00
2102022	01	04240	231	1020179	Rikonstruksion (veshje me beton) e kanalit vadites Lapardha	3,257,433.00
2102022	01	04240	231		Blerje mjet transporti mallrash (per transportin e druve)	1,500,000.00
2102022	01	04240	231		Blerje pajisje elektronike	150,000.00
		04260			Administrimi i pyjeve dhe kullotave	585,518.00
2102022	01	04260	231	1020188	Ndertim Lera malore ne fshatin Mbjesheve	585,518.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

		09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor			19,320.00
2102005	01	09120	602	9999999	Mallra dhe Shërbime të Tjera	19,320.00
		09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm			48,524,483.00
2102005	01	09230	602	9999999	Mallra dhe Shërbime të Tjera	23,823.00
2102005	01	09230	602	9999999	Blerje materiale hidroizolimi per konviktin e vjeter	300,000.00
2102005	01	09230	602	9999999	Blerje vegla marangozi	100,000.00
2102005	01	09230	602	9999999	Blerje cope tekstile per uniforma,kellef dysheku, peshqira	250,000.00
2102005	01	09230	231		Sistemi i ngrohjes qendrore e konviktit	5,000,000.00
2102005	01	09230	231		Blerje Kamera sigurie	100,000.00
2102005	01	09230	231		FV dyer dhe dritare pe Konviktin e vjeter	800,000.00
2102005	01	09230	231		Paisje Kombinat per shtrydhje dhe qerim fruta e perime	200,000.00
2102005	01	09230	231		Blerje elektroshtepiake	100,000.00
2102005	01	09230	231		Blerje makine qepese me aksesore	100,000.00
2102005	01	09230	231		Blerje jasteke per ne konvikte	120,000.00
2102001	01	09230	231	1020191	Ndertim shkolla "Babe Dude Karbunara" bashkefinancim me MASH, (86,703,425.6:346,813,702.40)	41,430,660.00
		10430	Përkujdesja Sociale			4,052,393.00
2102020	01	10430	6020	9999999	Materiale zyre	532,000.00
2102020	01	10430	6021	9999999	Materiale dhe sherbime speciale	650,000.00
2102020	01	10430	6022	9999999	Sherbime nga te tretet	523,000.00
2102020	01	10430	6023	9999999	Shpenzime transporti	190,000.00
2102020	01	10430	6024	9999999	Shpenzime udhetimi	94,393.00
2102020	01	10430	6025	9999999	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	175,000.00
2102020	01	10430	6029	9999999	Shpenzime te tjera operative	80,000.00
2102020	01	10430	231		Furgon per transport te frekuentuesve te qendres "Lira", bashkefinancim	1,488,000.00
2102020	01	10430	231		Kamera sigurie	100,000.00
2102020	01	10430	231		Elektroshtepiake kuzhine (sobe pjekje per gatime, aspirator)	120,000.00
2102020	01	10430	231		Karrige, poltron	100,000.00
					Total	69,056,981.41



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Tabela 3

Detajimi i Transfertës së Pakushtëzuar Sektoriale për projekte të veçanta të trashëguar nga viti 2022

Kod Instituc.	Kap. Fin	Programi	Llog.	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001	01	03280	231		Pagese TVSH-je te projekteve me financim te huaj "FIRE PREP Permiresimi i Mbrojtjes nga zjarri ne pyje ne Shqiperi dhe Greqi", i financuar nga BE nepermjet Programit Nderkufitar Greqi-Shqiperi , fond MFE	10,969,888
2102001	01	03280	231		Pagese Bashkefinancimi per projektin me financim te huaj "FIRE PREP Permiresimi i Mbrojtjes nga zjarri ne pyje ne Shqiperi dhe Greqi", i financuar nga BE nepermjet Programit Nderkufitar Greqi-Shqiperi, fond MFE	8,751,272
2102001	01	09120	231		Projekti Sherbime Multifunkionale ne sektorin e arsimit, fond MFE	2,500,000
2102001	01	03280	602	9999999	Shpenzime operative per mallra dhe sherbime	620,000
2102005	01	09120	602	9999999	Shpenzime operative per mallra dhe sherbime	2,280,000
					Total	25,121,160

Tabela 4

Detajimi i Të Ardhurave të Veta/Lokale të trashëguara nga viti 2022

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llogaria	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001	05	01110	602	9999999	Shpenzime operative (fatura te muajve nentor,dhjetor'22)	1,648,943.23
2102001	05	01110	6029	9999999	Shpenzime per pritje e percjellje	536,000.0
2102001	05	01110	6029	9999999	Shpenzime per projekte festash, aktivitete artistike, sociale, promovuese per zhvillimin e turizmit	5,000,000.0
2102001	05	01110	231		Program kontabiliteti	528,000.0
2102001	05	04520	230	1020107	Oponence teknike per objekte ndertimi	1,145,000.0
2102001	05	05100	602	9999999	Sherbimi i pastrimit (efektet e ndrysh. te pages min. 2021-2022)	10,282,000.0
2102001	05	10430	606		Transferta për Buxhete Familje & Individë	2,000,000.0
2102001	05	04520	231	1020182	Ndertim i shpatullave dhe kollonave (pilave) bashke segmente rakorduese me rrugen Gjeroven, Berat	2,000,000.0
2102001	05	04520	231	1020182	Rikualifikimi i aksit rrugor qe lidh rrugen "Parangoi" me rrugen "Muzak Topia"	420,600.0
2102001	05	10661	231	1020033	Kolaudimi i Banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara, Berat, 2021-2022	50,000.0
2102001	05	06370	231	1020033	Kolaudim objekte te ndryshme	1,194,000.0
2102001	05	09230	231	1020191	Ndertim shkolla "Babe Dude Karbunara" bashkefinancim me MASH, (86,703,425.6:346,813,702.40)	6,704,000.0
2102001	05	06260	231		Sistemi i kamerave ne qytet	30,000,000.0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

2102001	05	08130	231		Ndertim i fushave sportive, bashkefinansim me FSHF	11,000,000.0
2102001	05	01110	231	1020022	Pajisje zyre, kondicionere, pajisje elektronike	2,000,000.0
2102001	05	08130	231		Lodra argetuese per kendet e lojerave ne qytet	6,000,000.0
2102004	05	04520	602	9999999	Shpenzime per mirembajtje rruge e sheshe me asfalt	29,500,000.0
2102004	05	06260	231		Blerje peme per gjelberimin e qytetit	753,600.0
					Total	110,762,143.23

Tabela 5
Rishpërndarje e fondeve në programe buxhetore

Pakesime

Kod Instituc.	Kap. Fin.	Prog rami	Llog.	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001	05	03280	600	9999999	Paga	1,000,000
2102001	05	03280	601	9999999	Sigurime shoqerore	201,764
2102001	05	03280	602	9999999	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,000,000
2102001	05	03280	602	9999999	Shpenzime operative per mallra dhe sherbime	620,000
2102001	01	03280	231	1020186	Projekti FIRE PREP Permiresimi i mbrojtjes nga zjarri, bashkefinansim	4,000,000
2102001	05	03280	231	1020186	Projekti FIRE PREP Permiresimi i mbrojtjes nga zjarri, bashkefinansim	9,814,000
2102001	05	06260	231	1020186	Supervizim Projekti i ndricimit publik eficient, bashkefinansim	2,000,000
2102001	05	09230	231	1020191	Ndertim shkolla "Babe Dude Karbunara" bashkefinansim me MASH, (86,703,425.6:346,813,702.40)	41,430,660
2102001	05	04520	231		Asfaltim dhe shtrim rruges me beton, mirembajtje me cakull dhe tombino e mure mbajtes ne njesite administrative dhe lagjet e qytetit	12,622,000
2102001	05	10430	231	1020186	Projekti "Fuqizimi ekonomiko-shoqeror i Ballkanit Perendimor. Mbeshtetje per bizneset dhe punekerkesit", bashkefinansimi me HELP	2,950,000
2102001	05	01110	6029	9999999	Shperblim per nxenesit ekselente	400,000
2102005	05	09120	602	9999999	Shpenzime operative per mallra dhe sherbime	2,280,000
					Totali i Pakesimeve	82,318,424



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Shtesa

Kod Instituc.	Kap. Fin.	Prog rami	Llog.	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001	05	09120	231	1020186	Bashkefinancime ne projekte ne fushen e arsimit	2,000,000
2102001	05	06260	231	1020186	Bashkefinancime ne projekte ne fushen e sherbimeve publike	2,000,000
2102001	05	08220	231	1020186	Bashkefinancime ne projekte ne fushen e kultures	2,000,000
2102001	05	10430	231	1020186	Bashkefinancime ne projekte ne fushen e sherbimit social	2,000,000
2102001	05	01110	6024	9999999	Shpenzime udhetimi	2,500,000
2102001	05	01110	6029	9999999	Shpenzime per pritje e percjellje	2,468,424
2102001	05	10430	606	9999999	Projekti "Fuqizimi ekonomiko-shoqeror i Ballkanit Perendimor. Mbeshtetje per bizneset dhe punekerkuesit", bashkefinancimi me HELP	2,950,000
2102001	05	09230	6029	9999999	Shperblim per nxenesit ekselente	400,000
2102001	05	04520	230	1020107	Hartim projekte	31,000,000
2102001	01	01110	231		Riparim i godinave te njesive administrative dhe ndarje funksionale te zyres ne bashki	3,000,000
2102001	05	08130	231		Ndertim i fushave sportive, bashkefinancim me FSHF	5,000,000
2102001	05	08220	231		Hidroizolim dhe punime ne godinen e pallatit te kultures "M. Tutulani"	3,000,000
2102004	05	04520	602	9999999	Shpenzime per mirembajtje rruge e sheshe me asfalt	23,000,000
2102004	01	04520	602	9999999	Shpenzime per mirembajtje rruge e sheshe me asfalt	1,000,000
					Totali i Shtesave	82,318,424

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA MINISTRISË SË MBROJTJES , TË AMBIENTIT TË
NDODHUR NË KATIN PËRDHE TË GODINËS “ BASHKIA E VJETER “**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika 1.2, neni 54 ” Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak “, VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe menyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, VKM nr.834, datë 21.11.2012” Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore , që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat”

Propozon :

1. Të miratoj dhënien me qira Ministrisë së Mbrojtjes, me afat 5 vjet, , të ambientit me sipërfaqe 40 m², ndodhur në katin përdhe të godinës “ Bashkia e vjeter “ me nr.12/3 pasurie Indeks harte BR-J-8, Zona Kadastrale 8502, lagja “ 22 Tetori” , me destinacion “Ambjent pune për procesin e rekrutimit të kandidatëve për ushtarë aktivë rezervist në Forcat e Armatosura “.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave ,Transportit dhe Shërbimeve .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE ,TRANSPORTIT DHE
SHËRBIMEVE

RELACION

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA MINISTRISË SË MBROJTJES , TË AMBIENTIT TË
NDODHUR NË KATIN PËRDHE TË GODINËS “ BASHKIA E VJETER “

Të nderuar Këshilltare !

Ministria e Mbrojtjes bazuar në ligjin nr.9047,datë 10.07.2003” Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë ”, ka paraqitur pranë Bashkisë Berat , kërkesë nr.1911 prot, datë 12.4.2022, për marrjen me qira me afat 5 vjet të ambientit të ndodhur në katin përdhe të godinës “ Bashkia e vjeter “,lagja “ 22 Tetori ”, me destinacion “Ambjent pune për procesin e rekrutimit të kandidatëve për ushtarë aktivë rezervist në Forcat e Armatosura.

Ky ambient me nr.12/3 pasurie Indeks harte BR-J-8, Zona Kadastrale 8502, lagja “ 22 Tetori” , është në pronësi të Bashkisë Berat , miratuar me VKM-në nr.834, datë 21.11.2012” Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore , që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat”, te pronat që përdoren me funksion “Administratë “

Ky ambient ka ka nje sipërfaqe prej 40 m2 .

Nisur nga kërkesa e sipër cituar si dhe bazuar në VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe menyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ne kërkojmë miratimin e dhenies me qira të ambientit me afat 5-vjeçar.

Bashkëlidhur kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes.

Drejtor i M.C.P.T.SH

Erlin KUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KRYETARI**

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

**Z. Ervin CECA
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT**

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin “Për miratimin e dhënies me qira Ministrisë së Mbrojtjes , të ambientit të ndodhur në katin përdhe të godinës “ Bashkia e vjeter “.

KRYETARI

Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuç, Drejtor i Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi: Meleqe Spahiu,Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

MBI MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE PËRFUNDIMTARE E FAMILJEVE PËRFITUESE PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA,VITI 2023” .

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”, VKM nr. 454, datë 3.7.2019 “ Për procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese” , VKM nr. 458, datë 3.7.2019, VKM nr.629,datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, termave të referencës “Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2023-2024 sipas shkresës së M.F.E me nr.23964, datë 28.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1.Të miratoj , listën emërore përfundimtare e familjeve përfituese për projektin “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara,viti 2023” , përbërë nga 63 familje.

Bashkëlidhur projekt-vendimit lista përfituese .

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave ,Transportit dhe Shërbimeve .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE ,TRANSPORTIT DHE SHËRBIM

RELACION

MBI MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE PËRFUNDIMTARE E FAMILJEVE PËR FITUESE PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA,VITI 2023” .

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat e ka prioritet të saj strehimin e familjeve në nevojë, të pa favorizuara e me probleme sociale .

Për ti ardhur ne ndihmë kësaj shtrese është viti i katërt që bashkia aplikon për tu bërë pjesë e projektit “ Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“, duke qënë edhe bashkëfinacuese në masën 20% për vitet 2020 e 2021 dhe 30% për vitin 2022 e 2023.

Bashkëfinancimin në masën 30% të koston totale të projektit për vitin 2023, Ju e keni miratuar me Vendimin nr.2, datë 25.01.2023, por në ndryshim me tre vitet e mëparshme ,këtë vit kanë ndryshuar termat e referencës së projektit ,duke kërkuar që lista totale e përfituesve të projektit së bashku me vlerat perkatëse të preventivit për çdo familje të miratohet në Këshillin Bashkiak .

Grupi i punës i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.23,datë 11.01.2023 bëri hartimin e projekteve dhe preventivave , të familjeve të identifikuara më përpara nga administratorët e lagjeve dhe të njëjësive administrative, të cilat do të trajtohen me këtë projekt.

Numri total i familjeve qe do te trajtohen me kete projekt jane 63 familje, kosto totale e projektit është në vlerën 73,753,426 lekë , ku 30% (22,126,028 lekë) e koston totale e projektit do të jete bashkëfinancim i bashkisë .

Kategoritë e familjeve përfituese për këtë projekt sipas nenit 16 të ligjit 252/2018 ”Për strehimin social” janë :

- Familje që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar, invalid janë 12 .
- Familje nga Komuniteti Rom 18.
- Familje nga Komuniteti Egjyptian 4.
- Të moshuar 5 familje .
- Familje me përkrahje soviale 18, ndërsa pjesa tjetër janë familje me të ardhura shumë të ulëta .

Drejtore i M.C.P.T.SH

Erlin KUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin CECA
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe “Mbi miratimin e listës emërore përfundimtare e familjeve përfituese për projektin “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara, viti 2023” .

K R Y E T A R I
Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuç, Drejtor i Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Transportit

Rovena Shehu, Drejtorja e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave

Konceptoi: Meleqe Spahiu, Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE BASHKIA BERAT”

Në mbështetje të nenit 108 pika 1, 3 dhe 4, të nenit 109 pika 1, të nenit 113 pika 2, të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 3, nenit 8, të nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, të nenit 23 pika 10, të nenit 54, të nenit 55 pikat 2, 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; të nenit 12 pika 3, të Ligjit nr. 10463, datë 22/09/2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”; Ligjit nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar; Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”; Ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Ligjit nr. 7697 datë 07.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative”; VKM nr. 418 datë 27.05.2020, “Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”; VKM nr. 671/2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”; VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; VKM nr. 608 datë 17.09.2014, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”; VKM nr. 798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”; VKM nr. 319 datë 31.05.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”; VKM nr. 402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”; VKM nr. 957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; VKM nr. 452 datë 11.07.2012 “Për landfill-et e mbetjeve”, i ndryshuar; VKM nr. 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”; VKM nr.177 datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”; VKM nr. 705 datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”; VKM nr. 866 datë 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”; VKM nr. 765 datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”; VKM nr. 117 datë 13/02/2013 “Për kriteret në bazë të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”, i ndryshuar; Vendimit të KKT nr.1 Datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”; VKM nr. 428 datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të vend-depozitimeve të mbetjeve urbane”; VKM nr. 687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar; Udhëzim nr. 1738 datë 12.03.2015 “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”; Rregulloren nr.1 datë 30.03.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet që nga krijimi dhe

transporti i tyre për asgjësim"; VKB nr. 42 datë 30.10.2019 "Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve"; VKB nr. 5 datë 30.01.2020" Mbi miratimin dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë Berat".

Këshilli i Bashkisë mori në shqyrtim Rregulloren për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve që gjenerohen në territorin e Bashkisë Berat" dhe vëren se:

Qeveria shqiptare e ka konsideruar çështjen e mbetjeve si një ndër gjashtë prioritetet e saj. Dokumenti i Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (VKM Nr. 418/2020) - dokumenti i politikave kombëtare strategjike që ka përcaktuar synimet, objektivat, treguesit dhe shënjestrat për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake, jobashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri për periudhën 2020–2035, është zhvilluar mbi vizionin ose përceptimin e konceptit "zero mbetje", në mënyrë që mbetjet të grumbullohen dhe të trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe të ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.

Qeveria i ka dhënë rëndësi të madhe zbatimit të hierarkisë së mbetjeve, si dhe trajtimit dhe depozitimit fundor të tyre, duke vlerësuar që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore të ketë një vend të licencuar dhe me parametrat mjedisorë për të depozituar mbetjet e tyre (VKM Nr. 418, datë 27.5.2020).

- Ndërkohë Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 42 datë 30.10.2019, ka miratuar Planin Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (PVMIM), ku ka përcaktuar vizionin, objektivat, shënjestrat dhe treguesit e performancës për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në territorin e Bashkisë Berat.
- Rregullorja për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake që gjenerohen në territorin e bashkisë, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, ose masën e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive, synon zbatimin e kërkesave dhe standardeve të legjisllacionit sektorial në fushën e mbetjeve, kryesisht zbatimin e kërkesave dhe standardeve të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta" dhe akteve në nligjore të dala në zbatim të tij, zbatimin e kërkesave dhe arritjen e shënjestrave të Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035 (VKM Nr. 418/2020), zbatimin e kërkesave të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (Vendim i KKT nr.1/2020), si dhe zbatimin e PVMIM të Bashkisë.
- Rregullorja sanksionon se menaxhimi i integruar i mbetjeve bashkiake të trashëguara apo të atyre që krijohen do të bëhet sipas përparësive dhe shënjestrave të përcaktuara në PVMIM të Bashkisë, duke respektuar hierarkinë e mbetjeve, parimet e menaxhimit të integruar dhe mjedisor të mbetjeve të përcaktuara në Ligjin nr. 10463/2011, duke nxitur kështu përdorimin racional të burimeve, duke mbështetur ekonominë qarkulluese, zhvillimin e bizneseve të gjelbra dhe turizmin në Bashki.
- Rregullorja vendos standardet, normat, procedurat, ndalimet dhe penalitetet për një menaxhim, kontroll dhe disiplinim të sigurt, të duhur dhe të qëndrueshëm të mbetjeve, duke mbrojtur kështu shëndetin publik dhe mjedisin, duke mbështetur parandalimin e minimizimin e mbetjeve dhe pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve; për mbrojtjen e ujërave, ajrit, tokës, tokës bujqësore, bimëve ose kafshëve nga ndotja; eliminimin e ndikimeve negative në vendet me interes të veçantë kulturor dhe turistik, si dhe të shqetësimeve nga zhurmat ose erërat që prodhohen gjatë proceseve të menaxhimit të mbetjeve.

- Rregullorja mbështet qendrueshmërinë financiare të MIM përmes rregullimeve dhe procedurave që kanë të bëjnë me aspektet e përcaktimit e mbledhjes së tarifës së shërbimit, të drejtat, detyrimet si dhe marrëdhëniet e Bashkisë me tarifëpaguesit. Ajo përcakton gjithashtu standartet, rregullat e procedurat për pjesëmarrjen, konsultimin, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e publikut në sistemin e MIM.
- Rregullorja përcakton detyrimet dhe mekanizmat e llogaridhënies, vlerësimit dhe raportimit për performancën e shërbimit, si dhe rregullat e procedurat për mbajtjen, përditësimin, raportimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve në bashki.
- Rregullorja zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë dhe detajon të drejtat dhe detyrimet e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e menaxhimit të mbetjeve.

Për sa më sipër dhe pas diskutimeve, shqyrtimit në mbledhjen e këshillit bashkiak të rregullores dhe të raportit të Komisionit të Këshillit për Infrastrukturën, Këshilli i Bashkisë Berat:

V E N D O S I :

1. Të miratojë “Rregulloren e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve“, sipas raportit bashkëngjitur dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Emergjencave Civile Pronave Transportit dhe Shërbimeve, Agjencia e Shërbimeve Publike, operatorët privatë, si dhe persona të tjerë fizikë e juridikë që banojnë apo kryejnë biznes në territorin e bashkisë.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak të publikojë Rregulloren në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Berat.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ERVIN CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

”PËR MIRATIMIN E RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE BASHKIA BERAT”

Të nderuar Këshilltarë!

Qeveria shqiptare e ka konsideruar çështjen e mbetjeve si një ndër gjashtë prioritetet e saj. Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (VKM Nr. 418/2020), si dhe Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (Vendim i KKT nr.1/2020) janë dokumente të politikave kombëtare strategjike që përcaktojnë synimet, objektivat, treguesit dhe shënjestrat për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake, jobashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri për periudhën 2020–2035. Këto dokumente janë zhvilluar mbi vizionin ose perceptimin e konceptit “zero mbetje”, çka nënkupton që mbetjet të grumbullohen dhe të trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe të ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.

Ndërkohë, legjislacioni shqiptar për mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti ka përparuar ndjeshëm në përafrimin ligjor të direktivave të BE për mjedisin dhe mbetjet (kryesisht Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij) dhe ka paraprirë dhe udhëzuar hartimin e këtyre dokumenteve strategjike kombëtare.

Procesi i integritit të Shqipërisë në BE sjell kërkesa dhe standarde shtesë për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve. Por ndërkohë, kuadri ligjor i Shqipërisë për menaxhimin e mbetjeve është pjesërisht i harmonizuar dhe kërkohet që politikat e menaxhimit të mbetjeve të synojnë arritjen e objektivave të riciklimit të BE-së për 2030, ndaj Shqipëria duhet të promovojë më shumë ekonominë qarkulluese dhe të stimulojë parandalimin, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, veçanërisht kompostimin, për të reduktuar depozitimin e mbetjeve në landfille, duke përshpejtuar zbatimin e legjislacionit për rrymat e mbetjeve (Raporti i BE për Shqipërinë, 2022).

Qeveria i ka dhënë rëndësi të madhe legjislacionit për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, si dhe trajtimin dhe depozitimin fundor të tyre, duke vlerësuar që çdo njësi e vetë qeverisjes vendore duhet të ketë një vend të licencuar dhe me parametrat mjedisorë për të depozituar mbetjet e tyre (VKM Nr. 418, datë 27.5.2020), sipas zonave të mbetjeve dhe parashikimit të investimeve kapitale për impiantet e trajtimit të mbetjeve të përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve. Legjislacioni sektorial për mbetjet përcakton një sërë masash për menaxhimin e integruar të mbetjeve, veçanërisht në

lidhje me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim (VKM nr. 418/2014), grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre (VKM nr. 608/2014), menaxhimin e mbetjeve inerte (VKM nr. 575/2015), administrimin e mbetjeve spitalore (VKM nr. 798/2010), ambalazhet dhe mbetjet e tyre (VKM nr.177/2012), mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (VKM nr. 957/2012); menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës (VKM nr. 705/2012), bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre (VKM nr. 866/2012), grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura (VKM nr. 765/2012), ndërtimin dhe menaxhimin e vend depozitimeve të mbetjeve (VKM nr. 452/2012) si dhe standardet e rehabilitimit dhe funksionimit të venddepozitimeve (VKM 389/2018), kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane (Udhëzim nr. 1738 datë 12.03.2015); trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet që nga krijimi dhe transporti i tyre për asgjësim (Rregullore nr.1 datë 30.03.2007 e Ministrisë të Mjedisit), etj.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake është funksion i bashkisë (neni 23/10 i Ligjit 139/015). Ky është një nga shërbimet kryesore, më të shtrenjta dhe më komplekse që ofron bashkia. Në ushtrimin e kësaj përgjegjësie ligjore, Bashkia mbron mjedisin e shëndetit e njeriut dhe siguron menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve, përmirëson efikasitetin e përdorimit të mbetjeve si dhe pakëson ndikimet negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve natyrore dhe të tjera.

Pas reformës territoriale administrative në 2015, bashkia është përballur me sfida për financimin e shërbimit, arritjen e standardeve dhe shënjestrave kombëtare të shërbimit, shtrirjen e shërbimeve bazë të MMN, në veçanti grumbullimit dhe transportit, në të gjithë territorin e bashkisë, sidomos në zonat rurale të bashkisë, si dhe ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e tyre në mënyrë të diferencuar. Si për çdo shërbim bashkiak, Këshilli i Bashkisë (Këshilli) si organi qeverisës i bashkisë (nenet 108, 109 të Kushtetutës së R.SH) ka përgjegjësinë për ofrimin e shërbimit. Ai ka detyrimin të miratojë instrumentet e përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë për këtë shërbim; të miratojë mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimit, përsa kohë ato nuk janë të përcaktuara në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi; si dhe të miratojë çdo mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake dhe/ose për shoqëritë tregtare të ngritura nga Këshilli për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve (neni 32, i Ligjit 139/015).

Këshilli gjithashtu ka detyrimin të miratojë normat, standardet e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e shërbimit të mbetjeve (neni 54 i Ligjit 139/015), si dhe politikën dhe planin për menaxhimin e mbetjeve (neni 12/2 i Ligjit nr. 10463/2011).

Në këtë kuadër Këshilli përcakton rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve që gjenerohen në territorin e Bashkisë, ku përfshihen letra dhe kartoni, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, ose masa e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive. Këto rregulla mund të jenë më strikte sesa qëllimet dhe kërkesat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (neni 12/3 i Ligjit nr. 10463/2011). Kryetari i Bashkisë është

përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit administrativ të bashkisë (neni 21/12, i Ligjit nr. 10463/2011).

Bashkia ka detyrimin të mundësoj një sistem efektiv të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta bashkiake (MIM), përfshirë grumbullimin, transportin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe mbikëqyrjen e këtyre operacioneve, kujdesin e mëtejshëm për vendet e asgjësimit të mbetjeve, nëpërmjet ngritjes dhe operimit të një sistemi që optimizon të gjitha aktivitetet MIM, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementët e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale dhe pa degraduar mjedisin (nenet 3/32, 45 të Ligjit nr. 10463/2011).

Përcaktimi i përparësive dhe ngritja e sistemit për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake, të trashëguara apo të atyre që krijohen, do të bëhet sipas objektivave të përcaktuara në Planin Vendor të MIM (PVMIM) të Bashkisë Berat, ku janë përcaktuar vizioni, objektivat, shënjestrat dhe treguesit e performancës për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë Berat, duke pasur parasysh hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, si në vijim: a) parandalimin e mbetjeve; b) përgatitjen për ripërdorim; c) riciklimin; ç) rikuperime të tjera; d) asgjësimin (neni 6, i Ligjit nr. 10463/2011).

Për të mundësuar ofrimin me standard të shërbimit MIM, Këshilli Bashkiak ka përgjegjësinë të vlerësojë koston e përllogaritur nga ekzekutivi i Bashkisë (VKM nr. 319/2018) dhe të vendosë tarifën përkatëse, duke synuar mbulimin e kostove nëpërmjet tarifave, një koncept që u sanksionua për herë të parë nga Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe politikat sociale, si dhe të miratojë buxhetin afatmesëm dhe vjetor për shërbimin MIM (neni 54, i Ligjit nr. 139/2015). Bashkia i përcakton këto tarifa vetëm nëse e ofron shërbimin e mbetjeve dhe në rast se konsumi ose përfitimi i shërbimit të mbetjeve, në parim, është i matshëm për përdoruesit ose përfituesit. Ndërkohë, bashkia siguron që kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve të mbulohen nga krijuesi fillestar i mbetjeve ose nga zotëruesi aktual apo i mëparshëm i tyre, në përputhje me parimin “Ndotësi paguan” (neni 20 i Ligjit nr. 10463/2011).

Para miratimit të politikës, planit, rregullores, normave dhe standardeve, tarifës dhe buxhetit për shërbimin e mbetjeve, Këshilli angazhon qytetarët dhe grupet e interesit në procesin e vendimmarrjes, por edhe të zbatimit dhe monitorimit të shërbimit, si dhe garanton konsultimin e këtyre dokumenteve përpara miratimit të tyre (neni 18 i Ligjit 139/015, Ligji nr. 146/2014).

Në sigurimin e ofrimit të shërbimeve MIM, Bashkia ka detyrimin të respektojë shumë standarde ligjore kombëtare. Bashkia përmes kësaj rregulloreje merr parasysh detyrimin për t'i grumbulluar mbetjet e ngurta bashkiake në mënyrë të diferencuar për të lehtësuar ose për të përmirësuar rikuperimin dhe riciklimin e tyre (nenet 17, 18 të Ligjit nr. 10463/2011), të nxisë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për që llime kompostimi dhe digjestimi, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit si dhe përdorimin e materialeve të prodhuara nga mbetjet bio që janë të sigurta për mjedisin (neni 28 i Ligjit nr. 10463/2011).

Bashkia dhe kjo rregullore merr parasysh kërkesën se për të gjitha ndërtimet e reja, publike a private pronarët detyrohen të parashikojnë hapësira të posaçme, pranë rrugëve publike, për vendosjen e kontenierëve, kazanëve, koshave, si pikë për dorëzimin e mbeturinave dhe këto pika miratohen së bashku me projektin dhe planin e ndërtimit (neni 29, i Ligjit nr. 8094/1996).

Për çdo zonë pastrimi bashkia lidh kontratë me sipërmarrësit e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, me afat deri në 5 vjet dhe sipas dispozitave në fuqi të prokurimit publik (neni 20 i Ligjit nr. 8094/1996), Këshilli mund të vendosë ta japë këtë shërbim me koncesion apo partneritet publik-privat përfshirë shërbimet e mbledhjes, trajtimit, transferimit dhe depozitimit të mbetjeve (neni 4ç , i Ligjit nr. 125 datë 25.04.2013), si pjesë të politikës së bashkisë për bashkëpunimin me sektorin privat për përmirësimin e MIM dhe kjo rregullore efektikon edhe këto bashkëpunime.

Në çdo rast, menaxhimi i kontratave të pastrimit dhe monitorimi i performancës së kontraktorëve do të bëhen bazuar në standardet e kësaj rregulloreje, kushtet e punës dhe indikatorët e performancës të dakordësuara në kontratë.

Për të mundësuar menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve dhe sipas kërkesave të ligjit, bashkia ndërton një rrjet të integruar të impianteve për rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve (neni 22 i Ligjit nr. 10463/2011), ndërkohë që grumbullimi ose transportimi i mbetjeve, si dhe dorëzimi i mbetjeve të grumbulluara ose të transportuara në impiantet e trajtimit bëhet nga personat fizikë a juridikë të licencuar (neni 21/5 i Ligjit nr. 10463/2011), sipas standardeve edhe të kësaj rregulloreje.

Vendosja e sanksioneve ndaj ndotësve mjedisorë është një nga kapitujt e kësaj rregulloreje, me anë të të cilave synohet arritja e cilësisë dhe standarteve si dhe ulja e kostove të shërbimit. Këto parashikime penalizojnë subjektet që djegin mbetjet ose kontenierët, zhvendosin pikat e grumbullimit të mbetjeve, hedhin mbetjet në mënyrë të paligjshme, ndotin zonat publike, parkojnë mjetet para ose pranë pikave të kontenierëve, nuk pastrojnë vendet përreth lokaleve ose pikave ambulante të shitjes, etj (neni 37, i Ligjit nr. 8094/1996; neni 25ç i Ligjit nr. 10433/2011).

Rregulloja merr parasysh se çdo mbetje duhet të hidhet vetëm në kontenierët e caktuar për largimin publik të mbetjeve, ndërkohë që zbrazja e kontenierëve bëhet vetëm nga personat e autorizuar nga sipërmarrësi (neni 12, i Ligjit nr. 8094/1996).

Këshilli ka detyrimin të monitorojë dhe mbikqyrë nëse po arrihen rezultatet e parapara nga zbatimi i politikës, planit dhe rregulloreve për mbetjet dhe alokimi i fondeve për shërbimet MIM, pasi janë kyçe për të garantuar zbatimin e tyre dhe për të mundësuar llogaridhënien e ekzekutivit përpara Këshillit dhe të Këshillit përpara komunitetit. Për këtë, Këshilli merr në mënyrë periodike raporte nga ekzekutivi i bashkisë, përmes të cilëve informohet për ecurinë e zbatimit të këtyre dokumenteve të politikës dhe të planifikimit, me qëllim që të ketë një vendimmarrje të informuar në lidhje me përmirësimet e dokumenteve, rishikimit të objektivave dhe masave, rialokimet në kohë të burimeve financiare, si dhe marrjen e masave rregullatore dhe institucionale të nevojshme.

Për të garantuar një monitorim dhe mbikëqyrje efektive të planit dhe rregullores për mbetjet, Këshilli ka përgjegjësinë për të institucionalizuar sistemin e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit të performancës,

kryesisht përmes vendosjes së një sistemi efektiv të administrimit të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare, vendosjes së një sistemi treguesish, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës së shërbimit MIM, si dhe mundësitë të ngritjes së njësisë së posaçme në strukturën e bashkisë, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimeve MIM dhe e cila do të informojë Këshillin në mënyrë periodike, të strukturuar dhe mbi bazë të dhënash faktike, në lidhje me performancën e shërbimit dhe arritjen e standardeve që pë rrekon edhe kjo rregullore (neni 33 i Ligjit 139/2015).

Ndjekja e ecurisë së zbatimit të planit, rregulloreve dhe standardeve të mbetjeve bëhet mbi bazën e grumbullimit, mbajtjes, analizimit, përditësimit, raportimit dhe publikimit periodik dhe vjetor të statistikave të mbetjeve, në lidhje me sasitë dhe natyrën e mbetjeve të gjeneruara, grumbulluara, rikuperuara dhe asgjësuar (VKM nr. 687 datë 29.07.2015) dhe kjo rregullore ka dispozita për mënyrën e administrimit të statistikave.

Për të gjitha ato që u përmendën më lart, ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve është shumë kompleks, i kushtueshëm, kërkon politika afatgjata, vendosjen dhe monitorimin e standardeve të shërbimit, krijimin dhe zbatimin e një kuadri rregullator modern dhe të konsultuar me publikun, qendrueshmëri të financimit të shërbimit dhe garantimin e vlerës së kostos, investime të mëdha dhe afatgjata në impiante, mjete, teknologji dhe inovacion, mbikëqyrje të vazhdueshme të arritjes së performancës së shërbimit, ngritjen e strukturave eficientë dhe efikase të dhënies së shërbimit, instalimin e sistemeve moderne të menaxhimit, alokimin e burimeve njerëzore profesionale, instalimin e mekanizmave eficientë të bashkëpunimit me aktorë qeveritarë e jo-qeveritarë dhe biznesin, si dhe investimin e vazhdueshëm në edukimin, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve që ata të bëhen pjesë integrale e sistemit të MIM.

Rregullorja për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve bashkiake synon të mbështesë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10463/2011 dhe kuadrit në nligjor të dalë në zbatim të tij, zbatimin e kërkesave të Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035, zbatimin e kërkesave të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, si dhe zbatimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Berat, duke respektuar hierarkinë e mbetjeve, parimet e menaxhimit të integruar dhe mjedisor të mbetjeve, duke nxitur kështu përdorimin racional të burimeve, duke mbështetur ekonominë qarkulluese dhe zhvillimin e bizneseve të gjelbra dhe të turizmit në Bashki.

Rregullorja merr parasysh objektivin e bashkisë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, si dhe menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve të ngurta bashkiake në përputhje me standardet kombëtare dhe pritshmëritë e publikut. Ajo synon të përcaktojë mënyrën e administrimit mjedisor të mbetjeve bashkiake në territorin e Bashkisë në çdo fazë të menaxhimit, si dhe të mundësojë një monitorim efektive të vazhdueshëm në zbatimin e legjisllacionit dhe politikës kombëtare, rajonale dhe vendore për mbetjet që gjenerohen në territorin e bashkisë.

Kjo rregullore parashikon dispozita që detajojnë të drejtat dhe detyrimet e të gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe përcakton rregullat, mënyrën, teknikat e metodat e menaxhimit të integruar të mbetjeve në çdo fazë të tij.

Rregullorja vendos standardet, normat, procedurat, ndalimet dhe penaltetet për një menaxhim, kontroll dhe disiplinim të sigurt, të duhur dhe të qendrueshëm të mbetjeve të ngurta bashkiake, duke mbrojtur kështu shëndetin publik dhe mjedisin, duke mbështetur parandalimin e minimizimin e mbetjeve dhe pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve, për mbrojtjen e ujërave, ajrit, tokës, tokës bujqësore, bimëve ose kafshëve nga ndotja, eliminimin e ndikimeve negative në vendet me interes të veçantë, si dhe të shqetësimeve nga zhurmat ose erërat që prodhohen gjatë proceseve të menaxhimit të mbetjeve.

Rregullorja mbështet qendrueshmërinë financiare të MIM përmes rregullimeve dhe procedurave që kanë të bëjnë me aspektet e përcaktimit të mbledhjes së tarifës së shërbimit, si dhe të drejtat, detyrimet dhe marrëdhëniet e Bashkisë me tarifëpaguesit.

Ajo përcakton gjithashtu standardet, rregullat e procedurat për pjesëmarrjen, konsultimin, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e publikut në sistemin e MIM.

Rregullorja përcakton detyrimet dhe mekanizmat e llogaridhënjes, vlerësimit dhe raportimit për performancën e shërbimit, si dhe rregullat e procedurat për mbajtjen, përditësimin, raportimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve në bashki.

Rregullorja zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë dhe detajon edhe të drejtat dhe detyrimet e të gjithë palëve që zotërojnë, operojnë apo menaxhojnë mbetjet në territorin e Bashkisë Berat.

Kjo rregullore do të jetë bazë edhe për hartimin e rregulloreve për rryma të veçanta të mbetjeve bashkiake. Këshilli ka detyrimin të mbikqyrë, ndërsa Kryetari dhe administrata e Bashkisë ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore është hartuar në kuadër të projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, financuar nga Konfederata Zvicerane nëpërmjet SECO e zbatuar nga INFRASTRUKTUR&UMWELT në konsorcium me FLAG dhe SEHLHOFF.

Nga sa më lart ftojmë këshilltarët ta votojnë këtë projekt-vendim.

Faleminderit!

Drejtore
Erlin KUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin “Për Miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Bashkia Berat”.

KRYETARI
Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi, Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile Pronave Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi:

D.Gjogu, Përgjegjëse Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 3

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

MBI MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QE PËRFITOJNË BONUS QIRAJE

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”, pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës për 41 familje të pastreha që përfitojnë bonus qiraje për vitin 2023, sipas tabelës bashkëlidhur këtij projekvendimi .
2. Vlera e bonusit të qirasë do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i bashkisë dhe do të filloj për çdo familje sipas afatit të kontratës së qirase .
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave,Transportit dhe Shërbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E EMERGJENCAVE ,PRONAVE DHE TRANSPORTIT

RELACION

MBI MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QE PËRFITOJNË BONUS QIRAJE

Të nderuar Këshilltare !

Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit që Bashkia Berat ofron në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të pikës 34,45 nenit 2, neni 33,34 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", vkm nr.459,datë 3.07.2019 "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", për qytetarët në nevojë për t'u strehuar ,po ju sjellim listës e kërkesave për bonus strehimi, sipas formatit të kërkuar nga ministria përgjegjëse për strehimin ,shoqëruar me kostot financiare për çdo familje dhe listën e detajuar të familjeve përfituese .

Theksojmë se ,bazuar në legjislacionin në fuqi ,përfitojnë bonus strehimi nga buxheti i shtetit , vetëm ato familje që mbulojnë pjesën e mbetur të qerasë me të ardhurat e tyre ,ose nëpërmjet financimit të bashkisë.

Komisioni i Strehimit i mbledhur me datë 09.02.2023 mori në shqyrtim të gjitha kërkesat e bëra për bonus strehimi,ku rezultoi se mbas shqyrtimit të 54 kërkesave u kualifikohen 41 familje, ndërsa 13 kërkesa u s'kualifikuan për mungesë dokumentacioni.

Kërkojme nga ana Juaj miratimin e listës së familjeve të përbërë nga 40 familje që u kualifikuan nga Komisioni i Strehimit .

Bashkëlidhur lista e familjeve përfituese .

Drejtores
Erlin Kuçi

BASHKIA BERAT
K R Y E T A R I

Nr. _____ prot.

Berat , më ____ . ____ . 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues “Mbi miratimin e listës së familjeve që përfitojnë bonus qiraje për vitin 2023 ”

K R Y E T A R I
Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Rovena Shehu : Drejtorja e Menaxhimit Financiare dhe të Ardhurave

Erlin Kuçi : Drejtor i Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi:

Meleqe Spahiu, Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

PËR

**PËRCAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE
SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË BERAT**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 5, neni 6 shkronja “b”, nenit 10, pika 3, nenit 13, pika 1, shkronja “a”, nenit 14, pika 4, nenit 20, shkronja “dh”, dhe nenit 37, pika 1, të ligjit nr.10 279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 89/2022 “Për policine bashkiake”, të ligjit nr.10 431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, nenit 11, nenit 12, nenit 27, nenit 35, nenit 37 dhe nenit 38, të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, nenit 3 pika 32, nenit 18 pika 3, nenit 20 pika 1 dhe nenit 31, pika 12, të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, nenit 4, 8 pika 4, nenit 12, nenit 18 pika 1.2, nenit 29 pika 1, nenit 32 pika 1, shkronja “a”, “b” dhe “ç” dhe nenit 34, të ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, si dhe pika 7.7 shkronjat “m” dhe “n” dhe pika 7.8 shkronja “f”, të Shtojcës 1 bashkëlidhur këtij ligji, udhëzimin nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis”, nenit 66, nenit 73 dhe nenit 76, ligjit nr.107/2014 “ Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, vendimin e Këshilit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “ të ndryshuar dhe neni 34 i “Rregullores së administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, miratuar me vendimin nr. 447, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo subjekt juridik, individ fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në Bashkinë e Beratit.

2. Ky vendim përcakton kundërvajtjet administrative për shkeljen e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore në fushën e sigurisë publike, qetësisë dhe moralit publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to.

3 Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimin e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë së Berat, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që cenojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

Neni 2 Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Strukturë konstatuese”**, është çdo punonjës i strukturave të Bashkisë Berat që ka për detyrë funksionale konstatimin dhe dënimin e kundërvajtjeve administrative, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon dhe çdo strukture tjetër e ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë.

2. **“Bashkëjetesa shoqërore”** është tërësia e normave që përcaktojnë sjelljen/marrëdhënien e individëve në shoqëri, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës, nëpërmjet zbatimit të rregullit social, mbrojtjes së lirive e të drejtave individuale, sigurisë së jetës dhe veprimtarive të përditshme ekonomike-shoqërore, përfshirë këtu edhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit.

3. **“Funksion i Bashkisë Berat”** është fusha e veprimtarisë, për të cilën Bashkia si njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar, lirisht, tërësisht apo në një pjesë, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

4. **“Hapësirë publike dhe hapësira në bashkëpronësi”**, janë hapësira, si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitore, shesh pushime shkalle në pallate, rrugëkalime e mjedise të tjera në përdorim publik, që janë të pacenueshme dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre në shërbim të përdorimit publik, përveçse përmes dokumenteve të planifikimit, të parashikuara nga ligji.

5. **“Veprim”** është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngjashëm, apo sjellja e natyrës vetjake e çdo individit/qytetari, i cili kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie, që licenohet apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mire publike, që i nënshtrohet apo jo pajisjes me leje.

6. **“Licencë, leje, autorizim”** është akti administrativ, që i njëjti cdo subjekti apo individ të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, të drejtën të kryejë një apo disa veprime në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

7. **“Sanksionet administrative”**, janë akte administrative që lëshohen ndaj subjekteve nga strukturat konstatuese si rrjedhojë e shkeljes administrative të konstatuara.

Neni 3
Parimet bazë

1. Parimet themelore në bazë të të cilave udhëhiqet Bashkia e Berat dhe çdo strukturë e saj në veprimtarinë e tyre, janë: Ligjshmëria; Mos diskriminimi; Mbrojtja e të dhënave personale; Paanësia dhe parimi i drejtësisë; Mbrojtja, garantimi i interesit publik dhe jetës e shëndetit të qytetarëve dhe kontrolli dhe llogaridhënia.

Neni 4
Misioni dhe detyrat e strukturës konstatuese

1. Strukturat konstatuese, në varësi të Bashkisë Berat, në përmbushje të misionit dhe sipas fushës së kompetencave të tyre kanë si mision ruajtjen dhe garantimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore nga kryerja e veprimeve dhe/ose mosveprimeve të kundërligjshme në fushën e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor dhe sigurisë publike.

2. Çdo strukturë konstatuese, ka si detyrë të monitorojë, kontrollojë e të marrë masat në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për zbatimin e rregulloreve, urdhrave e udhëzimeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak apo Kryetari i Bashkisë, për probleme që lidhen me zbatimin e këtij vendimi apo përmbushjen e funksioneve të Bashkisë Berat si njësi e vetëqeverisjes vendore.

Neni 5
Bashkëveprimi me strukturat e tjera

Në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave, strukturat konstatuese të Bashkisë Berat dhe Bashkia e Berat, sipas rastit dhe nevoja bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me strukturat dhe institucionet e tjera shtetërore.

KREU II
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 6
Veprimtaria e lejuar në territorin e Bashkisë Berat

1. Në territorin e Bashkisë Berat, përfshirë këtu hapësirat publike dhe ato private, lejohen të kryhen vetëm aktivitete dhe veprimtari që janë në përputhje me qëllimin e kryerjes së tyre, duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe të përcaktuara dhe të rregulluara në aktet administrative dhe normative të nxjerra nga Bashkia Berat apo strukturat përgjegjëse të saj, nëpërmjet lëshimit të lejeve, autorizimeve dhe miratimeve përkatëse nga këto të fundit.

2. Çdo veprimtari apo aktivitet që ushtrohet në territorin e Bashkisë Berat, duhet të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse të lëshuara nga ky institucion.

3. Pavarësisht lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga entet publike shtetërore sipas fushës së kompetencave të tyre, çdo veprimtari apo aktivitet që zhvillohet apo synohet të zhvillohet në kundërshtim me këtë vendim, kritereve dhe rregullave të përcaktuara nga Bashkia e Berat, dënohet administrativisht dhe merren masa deri në mbylljen e aktivitetit që ushtrohet.

Neni 7

Zënia në kundërshtim me rregullat të hapësirës publike

1. Ndalohet zënia e hapësirës publike dhe hapësirave mbi apo nën të, në territorin e Bashkisë së Berat, qoftë edhe përkohësisht, me çfarëdo lloj sendi apo objekti pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo strukturës përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.
2. Zënia e hapësirës publike, veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me normat detyruese dhe rregullat e miratuara nga Bashkia e Berat dhe legjislacioni në fuqi, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas këtij vendimi, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për kundërvajtjet administrative.
3. Në rastin e zënies së hapësirës publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia e Berat apo në rastet kur subjekti e ushtron ose zhvillon aktivitetin në këto hapësira publike pa lejen përkatëse, strukturat konstatuese, veprojnë në përputhje me sanksionet administrative të parashikuara në nenin 15 të këtij vendimi.

Neni 8

Kundërvajtjet administrative në fushën sigurisë

Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e sigurisë publike, këto veprime:

- a. Zënia e trotuareve, rrugës dhe rrugëkalimeve që pengojnë lëvizjen për njerëzit dhe automjetet, pa miratimin e strukturës përgjegjëse;
- b. Hedhja e objekteve dhe sendeve të forta, që pengojnë zhvillimin normal të veprimtarive social kulturore, rekreative apo promovuese që zhvillohen në hapësirat publike;
- c. Përdorimi i banderolave dhe thirrjeve me përmbajtje fyese apo denigruese gjatë zhvillimit të aktiviteteve apo veprimtarive sportive, kulturore, fetare, artistike, si dhe gjatë zhvillimit të tubimeve dhe manifestimeve;
- ç) Hyrja e personave në ambientet ku zhvillohen aktivitete publike, rekreative apo promovuese, pa autorizimin e Bashkisë Berat;
- d. Braktisja e automjeteve ose i sendeve të tjera në rrugë, mjedise publike apo ambienteve të përbashkëta;
- e. Cenimi nëpërmjet bërjes së grafitëve ose shkrimeve, ndotjes me substanca të ndryshme apo me gërvishtja e ndërtesave private e publike apo objekteve të tjera publike, përveç rasteve kur kryhet në kuadër të veprimtarive artistike dhe me miratimin e strukturës përgjegjëse;
- f. Vendosja me ngjitje, kapsim apo çdo mënyrë tjetër, e afisheve ose postareve të ndryshme në ndërtesat private e publike apo në objekte të tjera publike, pa miratimin e strukturës përgjegjëse;
- g. Kryerja e veprimeve apo mosveprimeve, që vënë në rrezik jetën, shëndetin apo pronën e të tjerëve përmes vendosjes pa masa sigurie të vazove të luleve apo çdo send tjetër në

parvazet e dritareve, ballkoneve, në tarraca apo në çdo pjesë tjetër të mjediseve publike, të përbashkëta apo private;

h. Përdorimi i lëndëve piroteknike apo fishekjarrëve në çdo mënyrë që vë në rrezik shëndetin, jetën, pronën apo ambientin, në kundërshtim me legjislacionin për përdorimin e tyre;

i. Lëvizja e automjeteve në orët dhe vendet e rezervuara për këmbësorët;

j. Dëmtimi i mjediseve publike apo të përbashkëta, duke mos u ndalur vetëm në: shkallët e fasadat e pallateve, lulishteve, stolave, shatërvanëve, monumenteve, statujave dhe këndeve të lojërave;

k. Vendosja e pengesave të çfarëdo lloji për kufizim shpejtësie të lëvizjes të automjeteve si dhe ndërtimi i objekteve përkujtimore përgjatë rrugës, pa miratimin e organit përgjegjës publik;

l. Kryerja e çfarëdo veprimtarie në afërsi dhe pranë rrugëve, që rrezikon sigurinë rrugore, jashtë normave të sigurisë të përcaktuara nga Kodit Rrugor dhe pa miratimin e organit përgjegjës publik;

m. Zënia e vend parkimeve publike dhe vendeve ku lejohet parkimi në hapësirat pranë blloqeve të banesave me automjete më qëllim ekspozimin/ tregtimin e tyre apo qëllime të tjera biznesi;

n. Qarkullimi me mjete motorike, biçikleta në, shëtitore, parqe apo vende pushimi për qytetaret në orët e ndaluara sipas rregullave të përcaktuara nga Bashkia e Beratit dhe strukturat përgjegjëse të saj;

o. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, i parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga këshillit bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Beratit.

Neni 9

Kundërvajtjet administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës

1. Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime:

a. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese në mjediset publike nga muzika në bar-kafe, restorante dhe/ose lokale të tjera shërbimi, jashtë orareve të përcaktuara nga lejet përkatëse dhe legjislacioni në fuqi;

b. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese të çfarëdo lloji në ambientet e përbashkëta të banimit;

c. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese, në zonat e banuara nëpërmjet borive, muzikës së lartë të kasetofonëve në makina;

ç. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese nga punimet/ndërtime në mjediset publike dhe private, të kryera jashtë orareve të përcaktuara nga rregullat e fqinjësisë së mirë apo pa miratimin e organit përgjegjës publik;

- d. Djegia e mbeturinave apo ndezja e zjarreve në zonat e banuara, lulishte apo parqe në vende të papërcaktuara për këtë qëllim dhe pa lejen e strukturave përgjegjëse;
- e. Përdorimi i materialeve apo sendeve të ndryshme imituese, tymuese, rrezeve laser në ambiente të hapura dhe të mbyllura publike;
- f. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje parashikuar në aktet nënligjore të miratuar nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Beratit.

Neni 10

Kundërvajtjet administrative kundër moralit publik

- 1. Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e moralit publik, këto veprime:
 - a. Veprimet apo sjelljet e çdo natyre që kanë për qëllim ngacmimin, fyerjen apo talljen ndaj njerëzve më aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe të pambrojturve.
 - b. Dehja në mjedise të hapura dhe në mjedise të mbyllura publike kur shoqërohet me veprime që krijojnë shqetësim për të tjerët;

Neni 11

Kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit

- 1. Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit, këto veprime:
 - a. Djegia e mbetjeve urbane në kontenier, në Vend Grumbullimin e Mbetjeve (VGM - të), në territore private dhe publike.
 - b. Dorëzimi (hedhja) i mbetjeve në pusetat e elektrikut, ujësjellësit, basenet ujore, etj.
 - c. Dorëzimi i mbetjeve të vëllimshme, mbetjeve të ndërtimit, në kontenierët apo në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane.
 - d. Dorëzimi ditor i mbetjeve urbane në një volum më të madh se $\frac{1}{4}$ e volumit të një kontenieri publik.
 - e. Dorëzimi në kontenier apo në mjetet e përdorura për grumbullimin e mbetjeve, i mbetjeve të lëngëta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mira, i substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme për më tepër mbetje të forta apo kafshëve të ngordhura.
 - f. Dorëzimi i mbetjeve nga aktivitete prodhimi, përpunimi, trajtimi, etj. si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në kontenierët publik apo në Vend Grumbullimin e Mbetjeve (VGM – të).
 - g. Hedhja, derdhja në trotuare e ujërave dhe mbetjeve të ndryshme nga pastrimi apo larja e lokaleve të shërbimit, dyqaneve, etj.
 - h. Dorëzimi i mbetjeve urbane jashtë kontenierëve.
 - i. Hedhja e mbetjeve të çastit, ambalazhet, etj. hapësira publike apo të gjelbra.

- j. Dorëzimi i pasistemuar, i papalosur apo i pambyllur në qese i mbetjeve tregtarë, si dhe mosdorëzimi i tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia.
- k. Moskryerja e pastrimit, lejimi i ndotjes dhe mosmirëmbajtja e territoreve private të zbuluara, për të larguar në çdo mënyrë mbeturinat.
- l. Kryerja e selektimit manual, kërkimit apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenier, etj. nga persona të paautorizuar.
- m. Ndryshimi arbitrar i Vend Grumbullimit të Mbetjeve (VGM – ve), i kontenierëve, i pikave të koshave dhe stacioneve të betonuara për hedhjen dhe dorëzimin e mbeturinave të përcaktuara nga Bashkia.
- n. Hedhja, mbledhja dhe grumbullimi i materialeve, hekurishte apo çdo lloj mbetjeje dhe/ose të ricklueshme, në territore/hapësira publike apo dhe ambiente private që nuk janë miratuar nga Bashkia e Beratit për këtë qëllim.
2. Ushtrimi i aktivitetit për të gjitha veprimtaritë që për shkak të natyrës së tyre përdorin vazhdimisht gjeneratorë/ventilatorë apo çdo pajisje që shkakton ndotje akustike, nëpërmjet lëshimit të zhurmës në mjediset dhe zonave të banuara dhe nuk kryejnë vet-monitorim të nivelit të ndotjes akustike në rastet e përcaktuara nga bashkia, si:
- a. Furra të prodhimit të bukës;
- b. Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme;
- c. Bare, restorante e lokale nate;
- d. Dyqane/vende të tregtimit të kafshëve/shpendëve shtëpiake, të shoqërimit dhe të luksit.
- e. Gomisteritë, lavazhet apo serviset e që riparojnë mjete.
3. Shkelje të kryera në fushën e ndërtimit dhe të veprimtarive në funksion të saj, të shkaktuar nga subjektet ndërtues/investitorë, për kryerjen e veprimeve të mëposhtëm:
- a. Ndotje e hapësirës publike nga gommat dhe pajisjet e automjeteve të tipeve dhe tonazheve të ndryshme, të cilat dalin nga kantieri i ndërtimit pa marrë masat për pastrimin e tyre.
- b. Ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit, nga inerte apo materiale të tjera ndërtimore.
- c. Krijimi i ndotjeve të hapësirave publike gjatë transportimit, për rastet kur kamionët të cilët transportojnë materiale ndërtimore, nuk janë të mbuluar;
- d. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Beratit.

Neni 12

Kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike

Për aq sa nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e infrastrukturës publike, këto veprime:

1. Ndërhyrje në rrjetin rrugor, si:
 - a. Dëmtim, çarje, ndotje dhe bllokim rruge;
 - b. Dëmtim, çarje, ndotje trotuari dhe dëmtim bordure;
 - c. Dëmtim, bllokim pusete, kunete, vjedhje kapaku/zgarë pusete.
2. Ndërhyrje në rrjetin elektrik rrugor dhe rrjetin e telefonisë, si:
 - a. Lidhjet e pamiratuara në kandelabrat apo rrjetin ajror;
 - b. Dëmtimi i shtyllave apo ndriçuesve;
 - c. Përdorimi i shtyllave si suport mbajtës/mbështetës për montimin e reklamave, kapjen e kabllove elektrikë, telefonik, internetit, etj.
 - d. Dëmtimi i traseve kablore e linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me ose pa leje, si dhe shkulja e shtyllave.
3. Ndërhyrjet në rrjetin ujësjellësit, si:
 - a. Lidhjet e pamiratuara në tubacion;
 - b. Dëmtimi i pusetave;
 - c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre, me ose pa leje.
4. Ndërhyrjet në hapësirat publike dhe të gjelbër, si:
 - a. Dëmtim të hapësirës publike dhe të gjelbër, këputje, shkulje apo prerje: pemësh, shkurre e bimë dekorative, etj. në këto hapësira;
 - b. Vendosje postera reklamues pa leje, në: fasada, pemë, shtyllë, etj.
 - c. Vendosje tabelash, pankartash, banderola pa leje.

Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë Berat.

Neni 13

Kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike.

1. Për aq sa nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, këto veprime:
 - a. Të sigurojnë, që në ambientet e përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, kafshët/shpendët e tyre të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët/shpendët e tjera, duke zbatuar detyrimin, që:
 - Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip.

- Të vendosin maskat mbrojtëse për qentë e racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser.
 - Të shmangin ndotjen e ambienteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirave publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje, të pastrojnë ambientin pas defektimit.
 - Mbajtja dhe/ose rritja e kafshëve, bagëtisë ose shpendëve të çdo lloji, pavarësisht numrit është e ndaluar brenda të gjitha njësive të banimit ose pronës së përbashkët.
 - Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve blegtoralë jo shtëpiake, në mjedise publike të qendrave urbane si: kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula) etj;
2. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga Këshilli Bashkiak ose Kryetari i Bashkisë së Berat.

KREU III SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MËNYRA E CAKTIMIT TË TYRE

Neni 14 **Sanksionet/Aktet administrative**

1. Sanksionet/ Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim janë:
a. Paralajmërimi me shkrim/ Akt Konstatimi;

Sanksioni “paralajmërim me shkrim” është akti i konstatimit është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit, që jepet për një shkeljet të një rëndësie të vogël dhe/apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.

- b. Proces verbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.

Neni 15 **Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore**

Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë vendim:

1. Për kundërvajtjet në fushën sigurisë dhe rregullave të hapësirës publike të parashikuara në nenin 7 dhe nenin 8, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20 000 (njëzetmijë) lekë.
2. Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 9, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1000 (një mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
3. Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 10, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 2 000 (dy mijë) deri në 10 000 (dhjetëmijë) lekë.
4. Për kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit, Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve pranë Bashkisë Berat, do të vendosë gjobë:

- a. Në masën 1 000 - 5 000 (njëmijë deri në pesëmijë) lekë bazuar në shkallën e ndotjes, për konstatimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 11 dhe për çdo rast të përsëritur kjo masë do të dyfishohet deri në vlerën maksimale prej 20 000 (njëzetmijë) lekë;
- b. Në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 11 dhe për çdo rast të përsëritur kjo masë do të dyfishohet deri në vlerën maksimale prej 20 000 (njëzetmijë) lekë;;
- c. Në masën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në pikën 3 të nenit 11.

5. Për kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike, Agjencia e Shërbimeve Publike vetëm ose në bashkëpunim me Drejtorinë Lejeve, Planifikimit Urban dhe Investimeve, vendosë gjobë:

- Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 12;
- Në masën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 12;

6. Për kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, Agjencia e Shërbimeve Publike, do të vendosë gjobë:

- a. Në masën 1 000 (njëmijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 13, masë e cila dyfishohet në rast të përsëritjes së shkeljes brenda një periudhe 3 (tre) mujore nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve;
- b. Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 13, masë e cila do të jetë e dyfishuar në rast të përsëritjes së shkeljes nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve;

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 4 dhe 5 të këtij neni, kur Policia Bashkiake konstaton në kryerje e sipër kundërvajtjen në fushën e mjedisit e infrastrukturës publike, vendos menjëherë dënimin me gjobë sipas parashikimeve të kësaj pike. Në këtë rast Policia Bashkiake vendos në dispozicion të Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Agjencisë së Shërbimeve Publike një kopje të procesverbalit të gjobës.

Neni 16

Shpërblimi i dëmit dhe përlllogaritja e tij

1. Struktura konstatuese, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasojë e kundërvajtjes administrative, menjëherë vendos masën e gjobës për kundërvajtjen administrative, njofton strukturën përkartëse që është përgjegjëse për përlllogaritjen e dëmit të shkaktuar dhe dëmshpërblimin e tij.
2. Shpërblimi i dëmit dhe përlllogaritja e tij do të bëhet nga specialistët e fushës së strukturave përkartëse sipas legjislacionit në fuqi.
3. Struktura përgjegjëse vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ më vete vendos masën dhe mënyrën e shpërblimit të dëmit.
4. Shpërblimi i dëmit kryhet nëpërmjet zëvendësimit apo kthimit në gjendjen e mëparshme të pronës publike, sendit/objektit/hapësirës së dëmtuar ose duke paguar kundërvleftën monetare të dëmit të shkaktuar.

Neni 17

Mënyra e caktimit të dënimit

1. Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit në raport me shkeljen e konstatuar, dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe dispozitat e këtij vendimi.
2. Nëse personi fizik ose personi juridik ka kryer më shumë se një kundërvajtje nga ato të parashikuara nga ky vendim, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor, dënimi jepet për çdo kundërvajtje.
3. Në rastin kur disa kundërvajtje të kryera nga i njëjti person, konstatohen dhe shqyrtohen nëpërmjet të njëjtit procesverbal, caktohet një dënim me gjobë që përbëhet nga bashkimi i dënimeve me gjobë për secilën nga kundërvajtjet por jo më shumë se dyfishi i masës së gjobës së parashikuar për kundërvajtjen më të rëndë.
4. Nëse në kryerjen e kundërvajtjes kanë marrë pjesë më shumë se një person, dënimi jepet në mënyrë të veçantë për secilin kundërvajtës.

Neni 18

Rrethanat lehtësuese

1. Lehtësojnë sanksionin administrativ këto rrethana:
 - a. kundërvajtësi shpreh pendesë për veprimin e kryer;
 - b. kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, ka kompensuar humbjen ose eliminuar dënim e kryer;
 - c. kundërvajtja është kryer për shkak të rrethanave të rënda personale ose familjare;
 - d. kundërvajtja është kryer nga një grua shtatzënë.
2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënimi administrativ me paralajmërim ose dënimi administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.

Neni 19

Rrethanat rënduese

1. Rëndojnë sanksionin administrativ këto rrethana:
 - a. kundërvajtësi vazhdon veprimtarinë e paligjshme edhe mbas kërkesës për ta ndërprerë atë;
 - b. kundërvajtja është kryer nga më shumë se një individ apo grup individësh;
 - c. kundërvajtja është kryer gjatë një fatkeqësie natyrore ose rrethana të tjera të gjendjes së jashtëzakonshme;
 - d. kundërvajtja është kryer nën ndikimin e pijeve alkoolike, narkotike apo psikotrope.
2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënimi me gjobë në një masë afër nivelit maksimal të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.

KREU IV
**KOMPETENCA DHE PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE SHQYRTIMIT TË
KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE ZBATIMI I TYRE**

Neni 20

**Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative kundër
rregullave të bashkëjetesës shoqërore**

1. Strukturat konstatuese janë përgjegjëse për konstatimin dhe shqyrtimin e të gjitha kundërvajtjeve të parashikuara në këtë vendim, si edhe të çdo shkeljeje tjetër të përcaktuar nga Këshilli Bashkiak Berat apo kryetari i Bashkisë së Beratit.
2. Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.
3. Gjatë procedurës për konstatimin dhe shqyrtimin e një kundërvajtje administrative, strukturat konstatuese të Bashkisë së Beratit, nëse e sheh të nevojshme, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit të dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes apo shkeljes së konstatuar.

Neni 21

Procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve

1. Struktura konstatuese konstaton kundërvajtjen dhe e shqyrton atë menjëherë në vendin e kryerjes së saj.
2. Konstatimi dhe shqyrtimi i një kundërvajtje pasqyrohet në procesverbalin e kundërvajtjes, i cili përfshin, dënimin administrativ që jepet dhe sipas rastit shpërblimi dhe përlllogaritja e dëmit të shkaktuar.
3. Përpara nënshkrimit të procesverbalit të konstatimit dhe vendosjes së gjobës punonjësi konstatues i shpjegon kundërvajtësit shkeljen faktike të kryer, bazën ligjore për konsiderimin e saj si kundërvajtje administrative dhe dënimin administrativ që zbatohet. Kundërvajtësit i jepet mundësia për të paraqitur, aty për aty, komentet dhe shpjegimet përkatëse.
4. Procesverbali, si rregull, hartohet në prani të kundërvajtësit. Ai nënshkruhet nga punonjësi konstatues, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka të tillë. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, refuzon të nënshkruajë, nuk mundet të nënshkruajë apo refuzon të marrë procesverbalin, punonjësi konstatues bën një shënim të posaçëm në procesverbal dhe e vërteton këtë fakt nëpërmjet të paktën një dëshmitari.
5. Një kopje e procesverbalit i njoftohet kundërvajtësit nëpërmjet dorëzimit në vend. Në rastet kur kundërvajtësi refuzon të marrë kopjen e procesverbalit, ai konsiderohet i njoftuar. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, procesverbali njoftohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Dëshmitar, sipas pikës 4 të këtij neni, mund të jetë çdo person fizik me zotësi të plotë për të vepruar sipas përcaktimit të Kodit Civil, përfshirë këtu edhe një agjent tjetër konstatues.

Neni 22 **Procesverbali**

1. Modeli i procesverbalit për kundërvajtjen administrative dhe procesverbali për shpërblimin e dëmit miratohen nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjen administrative.

Neni 23 **Zbatimi vullnetar**

1. Gjohat paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve nga data kur ai bëhet gjoha bëhet e ekzekutueshme.

2. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, zbatohet një kamatëvonesë prej 2% (dy për qind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonesë. Shuma totale e kamatëvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.

3. Nëse gjoha paguhet vullnetarisht brenda 5 ditëve nga data kur ai bëhet i ekzekutueshëm sipas Kodit të Procedurës Administrative, aplikohet një zbritje prej 20% të masës të gjobës.

4. Pagesa vullnetare e gjobës dhe ose/kamatëvonesa bëhet në llogarinë bankare të strukturës që ka vendosur sanksionin administrativ.

Neni 24 **Ekzekutimi i dënimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv**

1. Ekzekutimi i Vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit, kryhet sipas legjit për kundërvajtjet administrative.

2. Të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera, të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kalojnë në Buxhetin e Bashkisë Berat.

Neni 25 **Procedurat e veprimit në rastin e kundërvajtjeve të tjera**

Kur struktura konstatuese krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik ose juridik, përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi dhe shqyrtimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

Ne rastet kur konstatohet se kundërvajtësi nuk ka shlyer dëyrimin e gjobës së aplikuar ndaj tij, nuk i ofrohen shërbime nga administrata vendore.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26
Urdhrat dhe vendimet

Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Berat që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratoj urdhrat dhe vendimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi. Për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë së Berat miraton formularët përkatës që duhet të përdoren nga strukturat konstatuese të Bashkisë.

Neni 27
Shfuqizime

Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 46, datë 09.12.2013 “Për miratimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksioneve përkatëse”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 28
Strukturat që ngarkohen me zbatimin e vendimit

Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Policia Bashkiake, Agjencia e Shërbimeve Publike, si edhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

K R Y E T A R
I KËSHILLIT BASHKIAK
Ervin CECA